



NDËRMARRJA PUBLIKE BANESORE SH.A.
PUBLIC HOUSING ENTERPRISE J.S.C.

Adr: Rr. Bill Clinton pn. Prishtinë-Kosovë
Tel: +381(0)38 553 311/523 001; Fax: +381 (0)38 522 446
e-mail: npb@npbanesore.com web: www.npbanesore.com

Nr. i Protokollit: _____ Data: _____

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A Prishtinë, shpall:

K O N K U R S

Për zgjedhjen e dy (2) Punëtorëve të Elektrikes në Departamentin e Intervenimeve Emergjente, në Ndërmarrjen Publike Banesore –SH.A me seli në Prishtinë.

Detyrat dhe përgjegjësitë specifike

- Kryen punime axhusterie, kuotimi, hapja e kanaleve, vrimave dhe foleve, shtrirja e kabllave dhe përçuesve, shtrirja e gypave, vendosja e kutive dhe tabelave, lidhja e qarqeve sipas skemave të instalimit, montimi i elementeve të instalimit, montimi i tabelave (ormanëve), montimi i kyçësit shtëpiak, kryerja e tokëzimit, instalimi i rrufepritësit, instalimi elektrik i një banese, vendosja e pajisjeve ndriçuese, instalimet mbi sipërfaqen e murit, instalimet elektrike në dysheme, instalimi i burimeve rezervë, instalimi i rrjetit të antenave televizive, instalimi i linjave telefonike dhe instalimi i interfonit.
- Është përgjegjës për punët e Departamentit të Intervenimeve Emergjente në punët e rrjetit të energjisë elektrike të tensionit të ultë.
- Zbaton detyrat dhe aktivitetet operative të përcaktuara nga Udhëheqësi i Departamentit të Intervenimeve Emergjente si dhe koordinon punët që lidhen me mirëmbajtjen e instalimeve të energjisë elektrike në hapësirat ku NPB operon si në mirëmbajtjen e rrjetave ekzistuese, riparimin e rrjetave të tensionit të ulët si dhe shtrimin dhe funksionalizimin e rrjetave me nivel të ulët të tensionit sipas kërkesave të NPB.
- Përgatitë dhe vendos në funksion energjinë elektrike nga kutia shpërndarëse dhe nga kutia deri në trafon furnizues të kyçjes së hapësirave të cilat mirëmbahen nga NPB.
- Mbanë përgjegjësi për materialin e shpenzuar si dhe shpenzimet e materialit i shënon në dëshmitë përkatëse sipas dokumentacionit të NPB për punët e mirëmbajtjes së instalimeve të energjisë elektrike.

Raportimet

- Bartësi i vendit të punës i raporton kryepunëtorit të grupit

Kualifikimet

- Shkolla e mesme profesionale
- Bartësi i vendit të punës duhet të ketë së paku 3 vjet përvojë pune .

Kualifikimet tjera

- Punëtori i Elektrikes duhet të ketë përvojë në fushën e elektrikes
- Aftësi të mira në punën ekipore.
- Aftësi të mira komunikuese.

Procedura e Konkurrimit

Kandidati-ja për pozitën ***Punëtor i Elektrikes në Departamentin e Intervenimeve Emergjente*** duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:

- CV-në;
- Dëshminë e Shkollimit;
- Dëshminë për Përvojën e Punës;
- Kopjen e Lejes së Njoftimit; dhe
- Referenca të tjera që janë të rëndësishme për këtë vend pune.

Dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen në këtë adresë: **Ndërmarrja Publike Banesore - SHA në Prishtinë, rruga "Xhevdet Doda", nr.32, Prishtinë** ose përmes e-mailit zyrtar: burimet.njerezore@npbanesore.com.

Kandidatët të cilët konkurrojnë duhet ta shënojnë saktë adresën dhe numrin e telefonit kontaktues, si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë. Dokumentet e pa kompletuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen. **Konkursi është i hapur nga data 22 Qershor 2019 – 07 Korrik 2019 ora 16:00.**